



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 203 prot.

Pukë, më 02.02.2026

PROJEKT VENDIM

Nr. 01 datë 02.02.2026

PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” (PAS VDEKJES) I BASHKISË
PUKË

Z. RRUSTEM FURRIKU

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.7, neni 54, germa “m”; ligjit nr. 94/2022 “Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.861 datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhenien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.71, datë 27.12.2024 “Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor “Për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pukë”, me propozim të kryetarit të Bashkisë Pukë, si dhe pas miratimit të Komisionit Këshillimor për Medaljet dhe Titujve Vendor të Nderit në Bashkinë Pukë, Keshilli i Bashkisë Pukë, në mbledhjen e tij me datë _____.02.2026;

Vendosi:

1. T’i akordojë titullin “QYTETAR NDERI” (pas vdekjes) i Bashkisë Pukë.

Z. RRUSTEM FURRIKU

Me motivacionin:

Në nderim dhe vlerësim të një prej mësuesve të parë të krahinës së Pukës, i cili me përkushtim të jashtëzakonshëm, frymë misionari dhe përgjegjësi të lartë qytetare, dha një kontribut të shquar në përhapjen e dijes dhe ngritjen e arsimit në shumë fshatra dhe komunitete të kësaj treve. Personalitet me vlera të larta njerëzore dhe qytetare, pasardhës i një familjeje që i ka paraprirë proceseve të rëndësishme historike, aktivist dhe veprimtar i palodhur në shërbim të komunitetit, për ruajtjen dhe promovimin e vlerave morale, kulturore dhe atdhetare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli i Bashkisë Pukë.

Paraqiten projektin;

Drejtori i Menaxhimit të BNJ.

Sokol Gjoni

Juristi

Aida Sinani

Kryetari

Rrok Dodaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 203 prot.

Pukë, më 02.02.2026

RELACION

PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” (PAS VDEKJES) Z. RRUSTEM FURRIKU

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Pukë

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.7, neni 54, germa “m”; ligjit nr. 94/2022 “Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.861 datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhenien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.71, datë 27.12.2024 “Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor “Për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pukë”, paraqitet për shqyrtim dhe miratim propozimi për dhënie të titullit “Qytetar Nderi” (pas vdekjes) z. Rustem Furriku.

Z. Rustem Furriku është një nga figurat e shquara të arsimit në krahinën e Pukës dhe ndër mësuesit e parë që hodhën themelet e përhapjes së dijes dhe ngritjes së shkollës shqipe në shumë fshatra dhe zona të thella të kësaj treve. Me përkushtim të jashtëzakonshëm, frymë misionari dhe ndjenjë të lartë përgjegjësie, ai ushtroi profesionin e mësuesit si një mision fisnik, duke i shërbyer komunitetit për dekada me radhë.

Kontributi i tij ka qenë vendimtar në arsimimin e brezave të tërë, në luftën kundër analfabetizmit dhe në formimin moral e qytetar të nxënësve. Me punë të palodhur dhe shembull personal, ai u bë frymëzim dhe model për nxënësit, kolegët dhe komunitetin, duke lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë e arsimit të Pukës.

Përtej misionit të tij si mësues, z. Rustem Furriku u shqua si personalitet me vlera të larta njerëzore dhe qytetare, pasardhës i një familjeje me kontribute të njohura në proceset e rëndësishme historike të zonës, si dhe aktivist dhe veprimtar i palodhur në shërbim të ruajtjes dhe promovimit të vlerave morale, kulturore dhe atdhetare.

Figura dhe vepra e tij gëzon respekt të gjerë në komunitet dhe konsiderohen pasuri e çmuar e trashëgimisë shpirtërore dhe arsimore të Bashkisë Pukë.

Për sa më sipër, vlerësojmë se z. Rustem Furriku i plotëson plotësisht kriteret për dhënie të titullit “Qytetar Nderi” (pas vdekjes) dhe propozojmë miratimin e këtij titulli nga Këshilli Bashkiak Pukë, si shprehje mirënjohjeje dhe nderimi për jetën dhe veprën e tij.

1. PROJEKT VENDIMI, Nr. 01, datë 02.02.2026

PËR DHËNIEN E TITULLIT 'QYTETAR NDERI' (PAS VDEKJES) I BASHKISË PUKË
Z.RRUSTEM FURRIKU

2. Miratimi i Komisionit Këshillimor.

Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Sokol Gjoni





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KOMISIONI KËSHILLIMOR PËR MEDALJET DHE TITUJT VENDOR TË NDERIT

Nr. 2036 prot.

Pukë, më 02.02. 2026

MIRATIM

PËR DHËNIEN E TITULLIT ‘QYTETAR NDERI’ I BASHKISË PUKË

Z. RRUSTEM NIMAN FURRIKU

(Pas vdekjes)

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 94/2022 “Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.861 datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhenien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.71, datë 27.12.2024 “Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor “Për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pukë”, si dhe VKB nr.70, datë 27.12.2024, “Për krijimin e komisionit këshillimor për medaljet dhe titujt vendor të nderit në Bashkinë Pukë”; pasi u njohëm me materialet dhe dosjen e plotë, përmes së cilës dokumentohet roli i z. Rrustem Furriku, si **“Një prej mësuesve të parë të krahinës së Pukës, i cili me përkushtim të rrallë dhe prej misionari dha një kontribut të vyer në përhapjen e dijes dhe ngritjen e arsimit në shumë fshatra të zonës. Frymëzues i brezave dhe shembull i përhershëm i mësuesit të vërtetë që ndriçoi rrugën e të tjerëve”**, shprehemi unanimisht për vlerësimin e tij të merituar nga Bashkia Pukë si “Qytetar Nderi”, (pas vdekjes).

KOMISIONI KËSHILLIMOR

1. Sokol Gjoni

2. Denisa Meçi

3. Endrit Kraja

4. Rasim Laçi

5. Ylli Hadroj